



Dalës-Izlazna

Nr. 1-UG
Br.

Data 20.09.2021
Datum

KOMUNA E OBILIQIT



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq-Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.27.08.2021, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Burim Gërguri, Florije Jashari, Fatmir Bekteshi, Hysni Mjeku, Qendresa Dubova, Linda Sadiku dhe Slavisa Spasic

Të pranishmit tjerë: drejtorët komunal e tjerë

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin financiar 2020 dhe plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga ZKA, për Komunën e Obiliqit për vitin 2020
4. Shqyrtimi i raportit financiar Janar – Qershor, 2021 të Kryetarit të Komunës
5. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së
6. Shqyrtimi i raportit të DKA-së
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Miratohet njëzëri trendi i ditës i cekur më lartë.

Pika e 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët e Komitetit ishin të pranishëm.

Pika e 2 e rendit të ditës

Miratohet njëzëri ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

Pika e 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet raportin e Zyres Kombëtare të Auditimit për vitin financiar 2020 dhe planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga ZKA, për Komunën e Obiliqit për vitin 2020. Ky raport është i pamodifikuar, ka vërejtje dhe sugjerime dhe paraqet një raport më të mirë se në vitin e kaluar. Gjithsejt janë 11 rekomandime, që një pjesë e tyre janë zbatuar edhe në vitin e kaluar.

Zarife Behluli – Siç e keni parë edhe ju, nga raporti i auditimit, ne e kemi bërë edhe planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, që ka qenë vetëm një theksim i çështjes nga 11 rekomandime. Ky theksim i çështjes ka pasë të bëjë me pagat jubilarë të administratës komunale që i kemi paguar në vitin 2020. Nga rezervat e pagave që është paraparë në vitin 2020, me u rregullue Ligji i Pagave, ju e dini se nuk është miratuar në Kuvendin e Kosovës. Në takimin e mbajtur me drejtorin e thesarit, Asociacionin e Komunave dhe të gjitha Drejtoritë e financave në nivel të Kosovës, na është sugjerue që rezerva e pagave jubilarë të zyrtarëve publik të alokohet në kategorinë mallra dhe shërbime, pasi që të bëhet shpenzimi me bë ndryshimin e shpenzimit dhe me lidhë me paga. Mirëpo, kjo nuk ka ndodhë dhe ne x kërkesa ia kemi drejtuar drejtorit të thesarit, që nuk është realizue dhe ka mbetë theksim i çështjes. Kjo nuk do të ndodhë më pasi që te pagat nuk ka pasë mjete të

mjaftueshme dhe kur është dashur të bëhet alokimi i mjeteve nga rezervat e pagave, nuk na kanë lejuar të alokohen mjetet te kategoria paga dhe meditje. Kjo ka ndodhë, por më nuk do të ndodhë.

Kryesuesi – Unë e lus Zyren e Prokurimit, që ato 2 çështje të theksuara nga auditori mos të na përsëriten. Zyra e Prokurimit, e ka obligim të raportoj para anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, për ndryshim plotësimin dhe planin e veprimit për vitin ekzistues.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimitisht ia rekomanduar Kuvendit komunal për shqyrtim Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin financiar 2020 dhe planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga ZKA, për Komunën e Obiliqit për vitin 2020.

Pika 4 e rendit të ditës

Zarife Behluli – Paraqiti gjerësisht raportin financiar Janar – Qershor të Kryetarit të Komunës, duke i përfshirë edhe Drejtorin të komunale.

Kryesuesi – Pyeti sa është numri i saktë që ne i kemi paguar personat me Covid 19. Në mbledhjen e Kuvendit, drejtoreshë duhet me na sjellë numrin e saktë të të prekurve me covid 19, të atyre që i kemi paguar dhe sa janë në proces. Nëse, janë paguar mbi 1,100 dhe kanë mbetë papaguar 10 vetë, neve nuk na e prish imazhin e 1,100-it, por pse me na mbetë 10 vetë. Mendoj se Drejtorja e shëndetësisë është mirë të na japë një raport rreth gjendjes së të vaksinuarve, në mënyrë që të dijmë përqindjen e popullatës.

Zarife Behluli – Përgjegjet nuk e di saktë, por janë mbi 1,000 raste. Mund të ndodhë që ne i kemi paguar personat me covid 19 dhe ai thotë se mjetet nuk më kanë dalë, por ne kur shikojmë këtu nuk ka pagesë të kthyer, ia kërkojmë raportin e bankës, pastaj thotë më fal se nuk i kam parë. Mund të ketë pagesa që kthehen sepse e sjellë emrin gabim, por edhe banka nganjëherë ndodhë që e gabon ndonjë numër të llogarive bankare dhe mjetet kthehen automatikisht. Përndryshe mjete ka pasë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimitisht ia rekomanduar Kuvendit komunal për shqyrtim raportin financiar Janar – Qershor 2021, të Kryetarit të Komunës.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga DEFZH-ja, për anulimin e vendimit nr.-I-103, të dt.04.08.2021, për transfer dhe rialokim të mjeteve dhe marrjen e vendimit për transfer dhe rialokim të mjeteve.

Zarife Behluli – Në bazë të konsultave me Departamentin e buxhetit, ne i kemi përfshi 3 fondet burimore nga grandi, të hyrat vetanake dhe të bartura, por nuk po lejohet që të hyrat e bartura të futen në 14.99 %. Tjetra është se te DMM-ja, është marrë buxheti total i programit dhe është dashur me qenë vetëm programi i DMM-së, kështu që te asfaltimi i rrugëve është zvoglue vlera për 4,391 €, dhe rregullimi i parqeve që është rialokim brenda Drejtorisë, është zvoglue vlera 3,406.44 €,

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimitisht ia rekomanduar Kuvendit komunal për shqyrtim kërkesën nga DEFZH-ja, për anulimin e vendimit nr.-I-103, të dt.04.08.2021, për transfer dhe rialokim të mjeteve dhe marrjen e vendimit për transfer dhe rialokim të mjeteve.

Pika 6 e rendit të ditës

Burim Gërguri – Ju veç e keni pranuar raportin e DKA-së dhe nëse, dikush nuk ka diçka për të thënë atëherë ia rekomandojmë Kuvendit komunal për shqyrtim.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimitisht ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim raportin e DKA-së, Komisioni nr.-I-95.

Pika 7 e rendit të ditës

Burim Gërguri – Paraqiti kërkesën nga DSHPE-ja, për ndarjen e mjeteve në vlerën prej 25,000 €, për Ndërmarrjen Publike Lokale “Kastrioti” SH.P.K. për funksionalizimin e Ndërmarrjes.


Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimitisht ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim kërkesën e Komisionit komunal të aksionarëve (përmes drejtorit të DSHPE-së) për ndarjen e mjeteve financiare për N.P.L. “Kastrioti” SH.A. sipas kërkesës nr.-VI-697, të dt.24.08.2021.

Kryesuesi – E kemi një kërkesë nga Nazmi Smaili, për ndihmë me mjete financiare për mirëmbajtjen e zyres të OVL-së, së UÇK-së, dega në Obiliq.


Kjo kërkesë me nr.-I-20145, e dt.26.08.2021, i rekomandohet Zyres së Kryetarit dhe DEFZH-së për shqyrtim.

Në fund ju lus që Drejtoritë përkatëse si dhe Zyra e Kryetarit ti shqyrtojnë rekomandimet e KPF-së, dhe të na njoftojnë në mbledhjen e Kuvendit komunal.

Mbledhja përfundoi në ora 10:58'

Bashk.prof.për punë të KK

Azize Zeneli



Kryesuesi i KPF

Burim Gërguri